

A low-angle photograph of a wind turbine against a clear blue sky. The turbine's three blades are visible, with one blade pointing towards the top right. The background is a solid blue color, and there are some white curved lines that separate the text area from the image.

ZBATIMI I POLITIKAVE DHE KËRKESAVE PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË DHE ENERGJI TË RIPËRTËRITSHME QË DALIN NGA MSA-JA, ARE-JA DHE PRE-JA

Nëntor 2020

AUTOR:
BALKAN GREEN FOUNDATION

PUBLIKIMI:
NËNTOR 2020

DIZAJNI DHE RRADHITJA:
TOMATO STUDIO

Botim i Balkan Green Foundation (BGF). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Ky dokument është hartuar në kuadër të projektit “Promovimi i Energjisë së Gjelbër në Kosovë” i mbështetur nga Qeveria Gjermane përmes Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Projekti i Kosovës për Eficiencë të Energjisë. Pikëpamjet e hartuesit të këtij dokumenti si dhe të dhënat e publikuara nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e GIZ-së.

Implemented by

**balkan
green
foundation**

Supported by



Implemented by

giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Hyrje	1
2. Metodologjia	4
3. Pasqyrë e përgjithshme e energjisë	6
4. Progresi i Kosovës në procesin e zbatimit të MSA-së	10
4.1 Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së - (PKZMSA)	10
4.1.1 PKZMSA 2017-2021	11
4.1.2 PKZMSA 2020-2024	15
5. Agjenda e Reformave Evropiane	18
6. Programet e Reformave Evropiane	23
7. Përfundimet	31
8. Rekomandimet	32

SHKURTESAT

ACER	Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë
GNK	Gazi Natyror i Kompresuar
BERZh	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
KE	Komisioni Evropian
TKE	Traktati për Komunitetin e Energjisë
SKE	Sekretariati i Komunitetit të Energjisë
ENTSO-E	Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit për Energji Elektrike
ARE	Agjenda e Reformave Ekonomike
ZRRE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë
PRE	Programi i Reformës Ekonomike
CPE	Certifikata e Performancës Energjetike
BE	Bashkimi Evropian
IRENA	Agjencia Ndërkombëtare për Energji të Ripërtëritshme
QK	Qeveria e Kosovës
GHG	Gazrat Serrë
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
HC	Hidrocentral
AKEE	Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë
KEDS	Shërbimet e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike në Kosovë
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
SKE	Strategjia e Kosovës për Energji
KESCO	Kompania e Kosovës për Furnizim me Energji Elektrike
KOSTT	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut në Kosovë
GLN	Gazi i Lëngshëm Natyror
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MEA	Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
MIE	Ministria e Integrimit Evropian
MMPS	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

KIMERK	Kllasteri i Industrisë së Metalit dhe Energjisë së Ripërtëritshme të Kosovës
MCC	Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit
MFK	Fondacioni i Mijëvjeçarit për Kosovë
NRD	Baza e të Dhënave e Regjistrit Kombëtar
PKVEE	Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencë të Energjisë
PKEK	Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë
PKZMSA	Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit
PKVER	Plani Kombëtar i Veprimit për Energji të Ripërtëritshme
PREE	Programi Rajonal për Eficiencë të Energjisë
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
TAIEX	Instrumenti i Komisionit Evropian për Asistencë Teknike dhe Shkëmbim të Informacioneve
TERMOKOS	Kompania e Ngrohjes Qendrore në Prishtinë
TC	Termocentral
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
BP	Ballkani Perëndimor
BB	Banka Botërore
REEP	Programi Rajonal i Eficiencës së Energjisë

1. Hyrje

Një herë e një kohë, thëngjilli i ka bashkuar vendet evropiane dhe ka ndihmuar në avancimin e jetesës së banorëve të Kosovës. Sot, thëngjilli është një pengesë e tmerrshme që e pengon Kosovën në përmbushjen e kërkesave energjetike dhe mjedisore për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian (BE) në të ardhmen.

Deklarata e Evropës është nënshkruar më 18 prill 1951. Kjo ka rezultuar në Traktatin e Parisit, që formoi Komunitetin Evropian për Thëngjill dhe Çelik (ECSC). Kjo ndodhi pas Luftës së Dytë Botërore. Me këtë janë normalizuar raportet ndërmjet Francës dhe Gjermanisë duke e vendosur prodhimin e thëngjillit dhe çelikut nën një organizatë të përbashkët dhe kështu duke shtruar rrugën për krijimin e Bashkimit Evropian.

Njëmbëdhjetë vjet më vonë, në tokën e “popullit të fundit të Evropës”¹ u ndërtua ‘Kosova A’, termocentrali i parë. Kjo ka pasur ndikim të madh në mënyrën e jetesës së njerëzve, duke krijuar kushte më të mira të jetës dhe punës, duke iu dhënë atyre hapësirë dhe mundësi për progres në jetët e tyre dhe për të zënë hapin me homologët e tyre perëndimorë.

Megjithatë, në 20 vitet e fundit të “perëndimizimit” të qytezave dhe qyteteve të saj, përdorimi në masë të madhe i energjisë së bazuar në thëngjill në Kosovë është duke ndikuar negativisht në shëndetin dhe mirëqenien e banorëve, mjedisin dhe biodiversitetin e saj. Sikurse vendet e saj fqinje, Kosova është bërë “pikë e nxehtë” (“hotspot”) sa i përket toksicitetit të ajrit për shkak të termocentraleve të vjetruara me thëngjill, përdorimit të karburanteve fosile nga ekonomitë familjare dhe djegia e drurit për ngrohje. Banorët e saj i ekspozohen disa nga absorbimeve më të larta të toksicitetit të ajrit: deri në pesë herë më të larta se sa nivelet udhëzuese të BE-së.

Edhe pse thëngjilli fillimisht i ka bashkuar kombet evropiane, sot të gjitha ia kanë kthyer shpinën thëngjillit dhe bashkëpunojnë për të transformuar bllokun prej 27 vendeve nga një ekonomi me karbon të lartë në një ekonomi me karbon të ulët për të rritur prosperitetin dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës së njerëzve. Ngecja e Kosovës sa i përket centraleve energjetike me thëngjill do të vazhdojë t'i diferencoj më tej banorët e saj nga Bashkimi Evropian. Kosova duhet t'i shtyjë përpara veprimet e saj për eficiencë të energjisë dhe energji të ripërtëritshme në mënyrë që vendi të përparojë.

Në muajin tetor të vitit 2015, Republika e Kosovës dhe Bashkimi Evropian nënshkruan marrëveshjen e parë kontraktuale, gjegjësisht MSA-në. Kjo marrëveshje paraqet një fazë të re të marrëdhënieve politike ndërmjet Kosovës dhe BE-së duke përcaktuar zyrtarisht mekanizma specifikë dhe afate kohore që do të harmonizojnë përfundimisht Kosovën me standardet e BE-së. Është thelbësore të theksohet që përveç që shërben si kornizë për ritjen e dialogut politik, MSA-ja gjithashtu shërben si lak për Kosovën që të ketë integrim më intim tregtar me BE-në.

1. Durham, M. E. (Mary Edith). (1909) Barra e Vendeve të Ballkanit (The Burden of the Balkans). Londër: Nel-son.

Për ta zbatuar me sukses MSA-në, në vitin 2015 Kosova ka hartuar dokumentin e saj kryesor të politikave, PKZMSA-në. Ky program ka për qëllim zbatimin e të gjitha reformave dhe miratimin e acquis të BE-së në legjislacionin kombëtar në të gjithë kapitujt e tij. Ky program zbatohet së bashku me dy dokumentet tjera specifike që monitorojnë dhe përshkruajnë shkallën e suksesit të përmbushjes së MSA-së: Agjenda e Reformave Evropiane (ARE) dhe Programi i Reformave Ekonomike (PRE).

ARE fokusohet në reformat kyçe ekonomike, forcimin e sundimit të ligjit dhe konsolidimin e qeverisjes së mirë, gjegjësisht zbatimin e reformave prioritare që kërkojnë vëmendje në nivelin më të lartë politik. Kjo e fundit përfshin reformat për nxitjen e konkurrueshmërisë dhe përmirësimin e rritjes gjithëpërfshirëse dhe krijimin e vendeve të punës. Në të njëjtën kohë, PRE-të dërgohen te Komisioni Evropian në baza vjetore nga kandidatët potencialë për anëtarësim në BE. Ato përmbajnë projeksione makroekonomike për tri vitet e ardhshme.

Kosova është njëra nga kandidatet e fundit për integrim në BE, së bashku me Bosnje Hercegovinën (statusi: kandidat potencial). Në përpjekjet e saj për reforma, Kosova gjithashtu është palë kontraktuese e Komunitetit të Energjisë. Brenda këtij komuniteti, Kosova ka pranuar të zbatojë një adaptim fundamental të legjislacionit të BE-së për energji, duke synuar përmirësimin e veprimeve të saj në efikasitet të energjisë dhe një integrim më të gjerë të burimeve të ripërtëritshme në miksin e saj të energjisë, ndër të tjera.

Ky punim do të ofrojë një analizë të Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA) dhe ndërlidhjes së tij me ARE dhe PRE në fushën e progresit në masat e efikasitetit të energjisë dhe burimeve të ripërtëritshme të energjisë. Për më tepër, ky punim do të ofrojë informacione në lidhje me procesin e monitorimit, performancën dhe efikasitetin e përmbushjes nga Kosova dhe do të ofrojë rekomandime konkrete se çfarë hapash duhet të ndërmerren nga Qeveria e Kosovës (QK) për ta përmbushur pjesën e saj të marrëveshjes me BE-në.



2 Metodologjia

Qasja e hulumtimit është një kombinim i shqyrtimit teorik të dokumentacionit referues të politikave dhe intervistave me akterët. Shqyrtimet e politikave ishin dokumente të publikuara nga autoritetet dhe donatorët dhe organizatat e ndryshme, siç janë: legjislacioni, strategjitë dhe planet kombëtare, raportet, punime kërkimore, etj.

Metodologjia hulumtuese është deduktive: grumbullimi i të dhënave, analizat dhe shqyrtimi i gjetjeve, vlerësimi i rezultateve dhe ofrimi i rekomandimeve. Të dhënat e grumbulluara nëpërmjet analizës krahasimore janë përpunuar sipas ndërlidhjeve me obligimet dhe rekomandimet për zhvillimin e përgjithshëm të Eficiencës së Energjisë (EE) dhe Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE), siç përcaktohet në PKZMSA, ARE dhe PRE; duke reflektuar masat dhe prioritetet që rrjedhin nga mekanizmat kombëtarë me rëndësi politike dhe të politikave të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe BE-së.

Në tërësi, hulumtimi është zhvilluar nëpërmjet 4 hapave kryesorë: 1) Lista e të gjithë dokumentacionit referues; 2) Informatat kthyes nga akterët kryesorë; 3) Analiza e të gjithë dokumentacionit referues (shqyrtimi kumulativ i racionales së zbatimit të obligimeve të Kosovës për masat për EE dhe BRE në kuadër të PKZMSA-së, ARE-së dhe PRE-së; shqyrtimi i komizës kombëtare të politikave, strategjive dhe planeve, etj.) dhe 4) Përmbledhja (vlerësimi i gjetjeve, identifikimi i çështjeve dhe sfidave kryesore të zbatimit dhe strukturimi i rekomandimeve gjithëpërfshirëse).

Në këtë punim është studiuar më tej statusi dhe niveli i zbatimit të objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara në tri dokumentet. Niveli i zbatimit reflekton statusin aktual kryesisht nga perspektiva legjislative dhe e zbatimit të transpozimit të acquis të BE-së në lidhje me EE dhe BRE.

Të intervistuarit janë përfaqësues nga institucionet e tilla, si: Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (ish- MZHE dhe MMPH), ish- Ministria e Integrimit Evropian (MIE), Agjencia Kosovare për Eficiencë të Energjisë (AKEE), Zyra e Rregullatorit të Energjisë, Komisioni Evropian (KE), Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Banka Botërore (BB), Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) në Kosovë dhe përfaqësuesit e sektorit privat, si Klasteri i Industrisë së Metalit dhe Energjisë së Ripërtëritshme të Kosovës (KIMERK).

Janë intervistuar shumica e akterëve të identifikuar, edhe pse procesi i intervistimit është përballur me kufizimet e mbylljes për shkak të pandemisë COVID-19. Një tjetër faktor kufizues ishin ndryshimet e bëra nga qeveria gjatë vitit 2020 dhe rotacioni i disa departamenteve nga një ministri në tjetër, p.sh. MMPH ka kaluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ambientit dhe tani në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.



3. Pasqyrë e përgjithshme e energjisë

Kosova ka përjetuar një “bum” të konsiderueshëm dhe të shpejtë ndërtimor në njëzet vitet e fundit, duke e zënë shtetin në ndërtim e sipër në befasi.

Trazirat politike, mungesa e sundimit të ligjit dhe privimi ekonomik kanë krijuar kushtet e përsosura për t’i dhënë krahë një kërkesë gufuese të komuniteteve rurale për t’u zhvendosur në zona rurale, duke e bërë ndërtimin sektorin me ritjen më të lartë në ekonominë e Kosovës.

Në vitin 2016, Qeveria e Kosovës identifikoi 350,000 ndërtesa, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik, pa leje të sigurisë dhe mjedisore.² Pasi që QK nuk kontrollon apo zbaton masat e kursimit të energjisë në ndërtesat e sektorit privat, këto masa mbasin në mëshirën dhe vullnetin e pronarëve.

Ndërtimi fizik i Kosovës ka qenë jashtëzakonisht i shpejtë; megjithatë, skema e shtetit më të ri të Evropës ka qenë e ngadaltë dhe e qëndrueshme. Mungesa e kodeve të ndërtimit ka bërë që qytetet e Kosovës të shndërrohen në xhungla betoni të ndërtuara me materiale me kosto të ulëta dhe pa izolim të duhur, duke çuar kështu në një ritje të kërkesës për energji elektrike. Njëkohësisht, mungesa e sistemeve të ngrohjes së qytetit dhe rrjeti joefikas kanë përshpejtuar përdorimin tradicional të djegies së linjtit dhe drurëve të zjarrit për ngrohje dhe gatim në ekonomi familjare dhe sektorin privat.

Kosova po përballlet me sfida në zhvillimin e efijencës së energjisë dhe burimeve të ripërtëritshme. QK ka marrë ndihmë nga donatorët, si Komisioni Evropian (KE), Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Banka Botërore (BB), Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC), Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), etj., të cilët investojnë dhe e ndihmojnë vendin në legjislacion dhe investime në projekte konkrete, të tilla si ndërtesat publike.

Megjithatë, Kosova ka një përdorim intensiv të energjisë elektrike në krahasim me mesataren e BE-së, pasi që Kosova përdor tri deri në katër herë më shumë energji për të njëjtën sasi të outputit të BPV. Ky është rezultat i mungesës së masave për efijencë të energjisë dhe pajisjeve tjera me efijencë të energjisë dhe nivelit të ulët të energjisë elektrike dhe termike të gjeneruar nga burimet e energjisë së ripërtëritshme.

Kosova është njëra nga burimet ndotëse më të mëdha në Evropë pasi që prodhimi i energjisë elektrike në Kosovë mbështetet pothuajse tërësisht në djegien e linjtit nga dy Termocentrale (TC) të vjetruara: “Kosova A” dhe “Kosova B”. Qeveria ka planifikuar zhvillimin e projektit për Termocentralin “Kosova e Re”; megjithatë, në vitin 2018, burimi kryesor i financimit të tij, BB, vendosi të tërhiqet

2. USAID në Kosovë (korrik, 2016). Storje suksesi “Ndërtimet pa leje në Kosovë drejt legalizimit”.



nga projekti, duke theksuar që kostot e energjisë nga burimet e ripërtëritshme janë shumë më të lira se sa tërëgjilji. Në muajin mars të vitit 2020, Contour Global nga ana e tij arriti në përfundim se zhvillimi i Termocentralit “Kosova e Re” është i pamundur dhe ata nuk do të vazhdojnë zbatimin e tij. Njoftimi nga Contour Global që nuk do të ndërtojë projektet e reja me tërëgjilji erdhi si rezultat i ndryshimit të thellë në qasjen e akterëve globalë politikë dhe financiarë, të cilët gjithnjë e më shumë po largohen nga projektet e tërëgjiljit dhe po fokusohen në të ardhmen e sistemeve energjetike, pra në efikasitet të energjisë dhe energji nga burime të ripërtëritshme. Organizatat joqeveritare lokale, të cilat vazhdimisht e kanë kundërshtuar projektin, theksuan “Është koha që QK t’i bashkohet këtij trendi të ri global dhe të shtrojë rrugën për tranzicionin e nevojshëm të tregut të energjisë në Kosovë”.³

Edhe pse QK ka bërë përpjekje për t’i adresuar shqetësimet alarmuese nga qytetarët e saj dhe Bashkimi Evropian, strategjitë e saja të bazuara në karbon vetëm se e kanë vonuar procesin e trajtimit të këtij rreziku mjedisor dhe shëndetësor. Inkurajimi i saj i politikave për investime në prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet në përgjithësi është investim i rrezikshëm, me një kthim të pakët ekonomik: kjo po dëmton në mënyrë të konsiderueshme komunitetet lokale dhe mjedisin.

Në një studim të bërë nga Grupi për Energji dhe Burime i Universitetit Berkeley të Kalifornisë, thuhet që energjia të cilën Kosova do të mund të gjeneronte përafërsisht nga burimet e biomasës është 6600 GWh/vit.⁴ Ndërkohë që vendet fqinje (Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Serbia) gjenerojnë një pjesë të energjisë elektrike duke i përdorur burimet e ripërtëritshme, në Kosovë ka mungesë të studimeve mbi potencialin e përgjithshëm të burimeve të energjisë së ripërtëritshme në Kosovë.

Në vitet e fundit, çmimet e teknologjisë për energji solare dhe të erës kanë pësuar rënie drastike, duke e bërë energjinë e qëndrueshme të mundshme për vendet si Kosova me financa të pakta, por me pozitë të duhur gjeografike.⁵ Edhe pse Kosova ka rezerva të konsiderueshme të erës⁶ dhe rrezatim të qëndrueshëm solar⁷, shfrytëzimi i tyre është ende i pamjaftueshëm.

Dokumentet e rëndësishme qeveritare që shërbejnë si udhërrëfyes për efikasitet të energjisë dhe burime të energjisë së ripërtëritshme janë Strategjia për Energji, Plani Kombëtar i Veprimit për Efikasitet të Energjisë (PKVEE) dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Energji të Ripërtëritshme (PKVER).⁸ PKVEE 2010-2018⁹ përcakton qëllimin e arritjes së caktuar të kursimit të energjisë prej 9% nga konsumi final i energjisë deri në vitin 2018.

Në vazhdim, PKVER 2011-2020 përcakton cakun prej gjithsej 25% të zhvillimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë në konsumin final të energjisë elektrike të ndarë në tre sektorë: (i) 25.64 % e burimeve të ripërtëritshme në konsumin final bruto të energjisë (ii) 10 % e burimeve të ripërtëritshme në konsumin final të energjisë në transport; dhe (iii) 45.65 % të BRE në konsumin final bruto për ngrohje dhe ftohje.

Megjithatë, Kosova ka arritur vetëm gjysmën e caqeve për efikasitet të energjisë (prej 9%) dhe nuk ka arritur caqet për energji të ripërtëritshme (22,9% nga 25% është arritur). Është thelbësore të theksohet që përqindja “e lartë” e pjesëmarrjes së energjisë së ripërtëritshme është më shumë rezultat i rishikimit të konsumit të biomasës¹⁰ se sa investimit në energji të ripërtëritshme.¹¹

Kosova është duke u vonuar në procesin e saj të integritimit në BE duke mos kaluar drejt sistemit të energjisë me karbon të ulët.¹² Megjithatë, ndikimi i degradimit mjedisor është më i dëmshëm se sa vonesa e Kosovës drejt integritimit në BE. Sipas Bankës Botërore, afërsisht 800 persona në Kosovë vdesin çdo vit drejtpërdrejt nga toksiciteti i ajrit.¹³ Për më tepër, bronhiti, sëmundjet e zemrës dhe kanceri i mushkërive janë sëmundjet kryesore me të cilat popullsia e Kosovës përballlet në vazhdimësi, gjë që krijon një ngarkesë jashtëzakonisht të madhe në sistemin shëndetësor dhe ekonominë edhe ashtu të dobët. Prandaj, QK duhet të ndër marrë hapa konkretë për të eliminuar ndotjen e ajrit nëpërmjet investimeve në energji të ripërtëritshme.



3. Balkan Green Foundation (mars 2020): <https://www.balkangreenfoundation.org/en-us/press/180/kosovo-now-has-the-opportunity-to-build-a-sustainable-energy-future/>

4. Kittner N, Dimco H, Azemi V, Tairyan E, Kammen D. Grupi për Energji dhe Burime, Universiteti i Kalifornisë, Berkeley. (2016). Opsionet për Energji Elektrike të Qëndrueshme për Kosovën.

5. Sipas Agjencisë Ndërkombëtare për Energji të Ripërtëritshme (IRENA), që nga viti 2010, kostoja e projekteve të reja solare fotovoltaike ka rënë për 82%.

6. Atlaset e erës për Kosovë. Në dispozicion online: <https://globalwindatlas.info/area/Kosovo> (qasur në muajin gusht të vitit 2020).

7. Atlasi Global i Energjisë Diellore. Në dispozicion online: <https://globalsolaratlas.info/downloads/Kosovo> (qasur në muajin gusht të vitit 2020).

8. Strategjitë përcaktojnë parimet e përgjithshme, aktivitetet, politikat dhe strategjitë në kuadër të sektorit të energjisë në vend dhe kanë për qëllim rritjen e efikasitetit të energjisë dhe burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

9. Agjencia e Kosovës për Efikasitet të Energjisë (AKEE) ka dërguar draftin final të PKVEE të 4-të në muajin tetor të vitit 2019, që mbulon periudhën 2019 – 2021 . PKVEE i 4-të përfshinë masat për transpozimin e Direktivës 2012/27/BE. Fatkeqësisht, miratimi i PKVEE të 4-të është ende në pritje.

10. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (2019). Raporti Vjetor i Zbatimit 2019.

11. Komisioni Evropian (2019). Raporti i Progresit për Kosovë.

12. Një rrugëtim që e filloi duke e nënshkruar Traktatin e Komunitetit të Energjisë: Edhe pse Kosova, sikurse vendet e tjera të BP-së, janë në udhëkryqin e zhvillimit të energjisë të përcaktimit të caqeve të reja për zhvillim të EE dhe BRE, BE-ja ka përcaktuar caqe më ambicioze për kursim për EE (32,5%) dhe caqe për pjesëmarrjen e BRE (32%).

13. Banka Botërore (2019). Raporti i Ballkanit Perëndimor – MCA në Kosovë. Raporti nr: AUS0001229.

4. Progresi i Kosovës në procesin e zbatimit të MSA-së

Qëllimi i MSA-së është të përcaktojë hapat konkretë të adoptimit gradual të reformave të politikave dhe atyre ekonomike përmes tre blloqeve: I) Kriteret politike, II) Kriteret ekonomike dhe III) Standardet evropiane - Përafrimi i Legjislacionit të Kosovës me acquis-in e BE-së.

Blloku II - Kriteret ekonomike, është në përputhje me PRE-të. Blloku III - Acquis-i i BE-së përfshin adoptimin e reformës së politikave në legjislacionin kombëtar dhe zbatimin e legjislacionit të përafruar. Ndahet në 33 kapituj të acquis-it të BE-së dhe një kapitull mbi përafrimin e legjislacionit kombëtar me acquis-in e BE-së.

ARE fokusohet në zbatimin e reformave prioritare që kërkojnë vëmendje në nivelin më të lartë politik. Prioritetet e ARE shërbejnë si kornizë afatmesme ndërsa plani i veprimit shërben si kornizë afatshkurtër.

PRE-të përgatiten nga qeveritë për të hartuar dhe zbatuar reformat në favor të rritjes, investimeve dhe punësimit. Aktivitetet e saj afatshkurtra sigurojnë që planet e punës së qeverisë të jenë në përputhje me aktivitetet e PKZMSA dhe ARE.

4.1 Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së - (PKZMSA)

Kapitulli numër 15 i PKZMSA-së i dedikohet sektorit të energjisë. Detyrimet e saj lidhur me energjinë përcaktohen brenda neneve 74¹⁴ dhe 114 të Bllokut të MSA-së. Ndërkohë që neni 74 promovon përafrimin legjislativ, neni 114 inkurajon zbatimin e acquis-it të BE-së për efikasitetin e energjisë, burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe ndikimin mjedisor të sektorit të energjisë. Veç kësaj, neni 114 thekson rëndësinë e bashkëpunimit midis Kosovës dhe SKE-së. Për më tepër, Blloku II (kriteret ekonomike) i MSA-së thekson rëndësinë e zvogëlimit të konsumit të energjisë përmes masave specifike të efikasitetit nën PRE.

Pjesa hyrëse e PKZMSA-së përcakton masat afatshkurtra dhe prioritetet afatmesme. Ajo gjithashtu paraqet situatën aktuale të Kosovës, si dhe kornizën e saj të politikave. Pjesa e dytë e PKZMSA-së përcakton standardet legjislative dhe zbatuese përmes një matrice të masave afatshkurtra.

14. Përafrimi i Ligjit të Kosovës me acquis të BE-së, Zbatimin e Ligjit dhe Rregullat e Konkurrencës.

QK ka miratuar pesë PKZMSA të njëpasnjëshme. Për këtë punim, do të analizohen PKZMSA 2017-2021 dhe 2020-2024. Të dyja promovojnë kursimet e energjisë, duke diversifikuar gjenerimin e energjisë përmes burimeve të ripërtëritshme, si dhe mbrojtjen dhe zbutjen mjedisore.

4.1.1 PKZMSA 2017-2021

Prioritetet afatmesme në kuadër të bllokut III janë: rishikimi i Strategjisë së Energjisë, zbatimi i caqeve të energjisë në përputhje me PKVER dhe PKVEE, krijimi i një Qendre të Vetme Shërbimi (One-Stop-Shop) për burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe për zbatimin e performancës së energjisë në ndërtesa (ndërtesa me pothuajse energji zero, certifikata të performancës së energjisë, lëshim të certifikatave të performancës së energjisë, inspektim të sistemeve të ngrohjes, inspektim të sistemeve të kondicionimit të ajrit, inspektim të sistemeve të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit).

Pjesa më e madhe e legjislacionit të kërkuar është adoptuar; megjithatë, QK ka dështuar në mënyrë të njëpasnjëshme për të siguruar zbatimin. Zbatimi i prioritetëve infrastrukturorë që ndikojnë drejtpërdrejt në efikasitetin e energjisë dhe varfërinë energjetike që po ndikon në jetesën e banorëve të saj zbatohet pjesërisht ose nuk zbatohet fare.

PKZMSA nuk i trajton efikasitetin e energjisë dhe burimet e ripërtëritshme të energjisë si prioritet i lartë. "Korniza e shpenzimeve sektoriale"¹⁵ përbëhet nga 19 objektiva prioritarë¹⁶, prej të cilëve, vetëm njëri trajton kursimet e efikasitetit të energjisë. Më konkretisht, nën-prioriteti 6.5, kërkon priorizimin e investimeve në efikasitetin e energjisë dhe mbrojtjen e mjedisit. Prioritetet e tjera kryesore si rritja e sigurisë së furnizimit me energji elektrike, investimet në kapacitetet e transmissioinit dhe shpërndarjes kanë penguar renditjen e efikasitetit të energjisë dhe burimeve të ripërtëritshme të energjisë si prioritet i lartë.

Vlen të theksohet se shumica e masave legjislative të planifikuara përsëriten nëpër dokumentet e PKZMSA-së të viteve të ndryshme. Shumica e masave zbatuese kanë të bëjnë me hartimin dhe miratimin e strategjive dhe planeve kombëtare të veprimit. Për shkak të mungesës së koordinimit ndërinstitucional në prioritetet dhe mekanizmat efektivë të monitorimit, masat zbatuese janë shumë të pakta për sa i përket sasisë dhe cilësisë për të pasur ndikim në kursimet në energji dhe zhvillim të projekteve të burimeve të ripërtëritshme.

15. Prioritetet për financim sipas Kornizës së shpenzimeve sektoriale. "Për periudhën 2017 – 2020, vendosen 19 objektiva prioritarë për adresimin e buxhetimit shtetëror afatmesëm dhe afatshkurtër për të siguruar përmbushjen e objektivave specifike të reformave në mënyrë që të sigurohet përmbushja e MSA-së dhe detyrimeve të tjera të integritetit evropian në fushat prioritare."

16. Kostimi dhe buxheti i prioritetëve afatmesme është përafruar përmes kapitullit "Korniza e shpenzimeve sektoriale", një lidhje midis buxhetit kombëtar dhe sektorëve prioritarë nën MSA/PKZMSA dhe ARE.

Tabela e mëposhtme 1. Matrica e aktiviteteve të PKZMSA 2017-2020 ka për qëllim vlerësimin e statusit dhe nivelit të zbatimit të efijencës së energjisë dhe burimeve të ripërtëritshme të energjisë të PKZMSA-së 2017-2020, që lidhen me masat afatshkurtra legjislative dhe zbatuese.

Tabela 1. Matrica e aktiviteteve të PKZMSA 2017- 2020

Masat legjislative	NZ	Masat zbatuese	NZ
1. Ligji për efijencë të energjisë.	4	1. Strategjia e Energjisë 2017-2026, e miratuar.	4
1. Rishikimi i UA për promovimin e shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme.	3	1. Programi i zbatimit të Strategjisë së Energjisë për 2017 - 2019, i miratuar.	3
1. Review of AI on the promotion of the use of renewable energy sources.	4	1. PKVER 2011-2020, duke përfshirë masat për të siguruar arritjen e cakt prej 25%.	4
1. UA për One Stop Shop për burimet e ripërtëritshme të energjisë.	4	*I miratuar.	
1. Rregullorja për përcaktimin e performancës minimale të energjisë në ndërtesat e reja në ndërtesat e banimit, ndërtesat në rinovim dhe ndërtesat e të gjitha llojeve përveç atyre të banimit.	3	1. PKVEE i tretë 2016-2018, i miratuar.	4
2. Rregullorja për çertifikatat e performancës së energjisë për ndërtesa të reja dhe ndërtesa të tjera.	3	1. Masat e EE-së në 20 ndërtesa publike të nivelit qendror.	4
3. Rregullorja për metodologjinë e llogaritjes minimale të performancës së energjisë.	3	1. Masat e EE-së në ndërtesa publike të nivelit lokal (Prishtinë, Gjiilan, Ferizaj dhe Gjakovë).	4
4. Rregullorja për sistemin e inspektimit të pajisjeve të ngrohjes dhe klimatizimit.	3	1. Numri i autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja të BRE	4
* Vetëm aktet nënligjore janë adaptuar; nuk është ekzekutuar asnjë implementim.		*Janë lëshuar disa autorizime për kapacitetet e BRE.	

NZ-Niveli i Zbatimit: 1 - I papërfunduar (Qeveria nuk e ka adresuar reformën ose qeveria ka ndërmarrë vetëm hapa fillestarë për të zbatuar reformën); **2 - Në proces** (Qeveria është duke zbatuar reformën me disa rezultate fillestare); **3 - Pjesërisht i përfunduar** (Zbatimi i reformës është në fazë të avancuar dhe mbështetet nga rezultatet); **4 - I përfunduar** (Reforma është zbatuar plotësisht).

Siç shihet nga tabela, janë marrë të gjitha masat e parashikuara. Shumica e masave kanë planifikuar veprimin një hapësh (si adoptimi i akteve nënligjore) dhe atyre u mungojnë tregues të mëtejshëm të monitorimit të zbatimit. Edhe pse në tavolinë gjithçka mund të duket në rregull, shumë prej masave nuk janë duke u zbatuar siç duhet, plotësisht ose fare.

Masat kryesore të reformës kërkojnë miratimin e Ligjit për efijencë të energjisë (1.1, shih tabelën 1.) dhe Strategjinë e energjisë 2017-2026 (2.1.), që nënkupton përcaktimin e kornizës legjislative dhe strategjike për efijencën e energjisë dhe zhvillimin e burimeve të ripërtëritshme.

QK ekzekutoi të dy masat por dështoi në ekzekutimin e implementimit in situ. Ligji për efijencë të energjisë¹⁷ u miratua në vitin 2018, por është jo i zbatueshëm për shkak të mungesës së legjislacionit sekondar. Për dy vjet me radhë, QK ka dështuar në adoptimin e “Udhëzimeve Administrative”¹⁸ tashmë të hartuara, që rrjedhin nga Ligji për efijencë të energjisë. Është diskutabile nëse QK do të duhet të ndryshojë Ligjin për efijencë të energjisë, pasi që i njëjti transpozon pjesërisht Direktivat e fundit të BE-së.¹⁹

Krijimi i një fondi specifik të efijencës së energjisë u kërkua shumë më herët gjatë procesit. Ligji për efijencë të energjisë përcakton kornizën legjislative për krijimin e Fondit të Efijencës së Energjisë të Kosovës (KEEF), duke krijuar mekanizma për financimin e masave të efijencës së energjisë. Operacionalizimi i KEEF-së këtë vit vlerësohet si një progres, megjithatë fondi duhet të fillojë zbatimin e masave në sektorin privat.

Megjithëse Strategjia e Energjisë 2017-2026 (2.1) është adoptuar në janar të vitit 2018 dhe Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë 2018-2020 (2.2) është adoptuar në korrik të vitit 2018, as njëra e as tjetra nuk janë duke u zbatuar plotësisht. Sigurimi i furnizimit me energji në kuadër të të dy dokumenteve mbështetet në ndërtimin e TC ‘Kosova e Re’ dhe rehabilitimin e TC ‘Kosova B’. Anulimi i të parit dhe stërzgjatja e të dytit krijojnë nevojën për një strategji të përditësuar të energjisë. Bazuar në situatën e re, kontekstin e përgjithshëm të energjisë dhe rishikimin e efijencës së energjisë dhe caqeve të burimeve të ripërtëritshme, strategjia e re duhet të përditësohet për të pasqyruar zhvillimet e tilla në mesin e prioriteteve të tjera. Fatmirësisht, QK tashmë ka filluar procesin e përditësimit të strategjisë së energjisë për periudhën 2021-2030.²⁰

PKZMSA 2017-2021 kërkon adoptimin e PKVER 2011-2020 (2.3). PKVER përcakton cakun prej 25% nga burimet e ripërtëritshme të energjisë me koston më të ulët të mundshme. Në vitin 2016, Kosova arriti një pjesëmarrje prej 24,6% (pjesë e llogaritjes është pjesa e biomasës së druve të zjarrit prej 18,9% për ngrohjen e ekonomive familjare²¹) të energjisë së ripërtëritshme në konsumin final bruto të energjisë, pikërisht në përputhje me cakun e vitit 2020 të saj prej 25%. Në vitin 2017, pjesëmarrja e energjisë së ripërtëritshme ishte 23,6%, më e ulët se në vitin 2016.” Një faktor shumë më i vogël është raportimi i prodhimit më të vogël të energjisë elektrike nga hidrocentralet më të mëdha, për shkak të kushteve të përkeqësuar hidrologjike.²²

17. Ligji Nr. 06/L-079 për efijencë të energjisë. Gazeta Zyrtare, Kosovë.
18. Intervistë me Avni Sfishta, Udhëheqës i ekipit, Projekti i Kosovës për efijencë të energjisë, GIZ Kosovë.
19. Komisioni Evropian (2019) Raporti i Progresit për Kosovën.
20. Intervistë me Besiana Qorraj, përfaqësuese në Departamentin e Energjisë, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit.
21. Sipas rregulloreve të BE-së, përdorimi i biomasës së drurit për ngrohjen e ekonomive familjare konsiderohet energji e gjeneruar nga BRE.
22. Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Raporti i Progresit të Energjisë së Ripërtëritshme të Republikës së Kosovës 2016-2017 (2018).

Kosova u zotua të transpozojë direktivën përkatëse të BE-së për performancën energjetike të ndërtesave. Pas miratimit të Ligjit për performancën energjetike të ndërtesave²³ në vitin 2016,²⁴ pas dy vitesh në dhjetor të vitit 2018, QK më në fund adoptoi tre rregulloret teknike që burojnë nga ligji (1.5., 1.6., 1.7., 1.8.).

Edhe pse Kosova e ka adoptuar me sukses kornizën rregullatore, zbatimi i saj ka stagnuar. Me mbështetjen e Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, ish-MMPH ka zhvilluar suksesshëm tipologjinë kombëtare të ndërtesave për sektorin e banimit dhe Modelin-Databazën e Regjistrimit Kombëtar (NRD) për ndërtesat. Fatkeqësisht, edhe pse NRD është funksionale, asnjë ndërtesë e vetme me Certifikatën e performancës së energjisë (EPC) nuk është listuar në kuadër të databazës. E njëjta rregullore përcakton kornizën ligjore për licencimin e auditorëve dhe vlerësuesve të energjisë. Nuk ka auditorë të certifikuar të energjisë dhe vlerësues të energjisë në Kosovë²⁵; pra, nuk lëshohen EPC-të. Si pasojë, legjislacioni i adoptuar nuk po zbatohet plotësisht. Fatmirësisht, MEA aktualisht është në mes të procesit të licencimit të 40-200 auditorëve të energjisë dhe vlerësuesve të energjisë.²⁶

Veç kësaj, Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë (AKEE), siç rekomandohet nga Komisioni Evropian (KE)²⁷ dhe SKE, duhet të funksionalizojë platformën e monitorimit dhe verifikimit. Funksionalizimi i plotë dhe përdorimi i sofuerit ISBEM²⁸ për llogaritjen e performances energjetike në ndërtesa është ende në proces, siç raportohet nga AKEE.²⁹

PKZMSA 2017-2021 trajton çështjet e Qendrës së Vetme të Shërbimit (One-Stop-Shop) për burimet e ripërtëritshme të energjisë (1.4.). Pas adoptimit të rregullores për Qendrën e Vetme të Shërbimit 'One-Stop-Shop'³⁰, nga viti 2018 është themeluar një grup ndërinstitucional për racionalizimin dhe thjeshtësimin e procedurave ekzistuese për dhënien e lejeve dhe licencave. Sidoqoftë, SKE i ka rekomanduar ZRRE-së që të përmirësojë "Transparencën dhe mos-diskriminimin midis prodhuesve të energjisë së ripërtrishme".³¹ Për më tepër, mungesa e mekanizmave efikas të mbikëqyrjes iu ka mundësuar disa ofruesve që të mos i përmbahen plotësisht kushteve të kontratës, duke çuar në çështje mjedisore dhe sociale. ZRRE-ja duhet të vendosë një procedure më të drejtpërdrejtë dhe transparente të Qendrës së Vetme të Shërbimit ('One-Stop-Shop') për lëshimin e licencave.

Për më tepër, PKZMSA kërkon zhvillim të vazhdueshëm të projekteve të burimeve të energjisë së ripërtrishme. Sidoqoftë, QK duhet të zhvillojë me kujdes hidrocentralet e reja dhe të kryejë vlerësime konkrete të ndikimit mjedisor për secilin projekt të ri. ZRRE-ja ka dështuar në sigurimin e standardeve mjedisore në disa projekte të burimeve të ripërtrishme. Aktualisht ekziston një vendim

sipas të cilit ZRRE-ja nuk është duke lëshuar më licenca të reja për hidrocentrale. Në vend që të marrë një vendim ad-hoc, QK duhet të miratojë një strategji të re të qëndrueshme për zhvillimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë bazuar në burimet që Kosova tashmë i posedon si rrezatimi solar dhe ato të erës.



4.1.2. PKZMSA 2020-2024

Edhe në PKZMSA-në e re, eficienca e energjisë dhe burimet e ripërtëritshme nuk konsiderohen si prioritet. Objektivat e vendosura brenda dokumentit nuk janë aspak ambicioze dhe nuk paraqesin hapa konkretë që do të ndihmonin në zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqohet Kosova në këta sektorë. Gjithashtu, përpjekjet që Kosova ka ofruar në lidhje me eficiencën e energjisë dhe burimet e ripërtëritshme janë minimale. Kjo mund të vërehet nga fakti që shumica e objektivave të përcaktuara pritet të përmbushen nga donatorët dhe investitorët privatë. Vendosja e agjendës së eficiencës së energjisë dhe burimeve të ripërtëritshme të energjisë në duart e partnerëve të jashtëm krijon pasiguri për shkak të ndryshimeve që mund të ndodhin në vazhdim e sipër.

Prandaj, Kosova duhet të zhvillojë një sërë objektivash në PKZMSA, të cilat jo vetëm që e vendosin eficiencën e energjisë dhe energjinë e ripërtëritshme si një prioritet të lartë, por gjithashtu krijojnë një mjedis të favorshëm që do t'i jepte shtysë zhvillimit të tyre brenda sektorit publik dhe privat.

23. Ligji nr. 05/L-101 për Performancën Energjetike në Ndërtesa. Gazeta Zyrtare, Kosovë.

24. Ish-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) mbështetur nga Programi Rajonal për Eficiencë të Energjisë (PREE).

25. Intervistë me z. Arben Ajazi. Departamenti i planifikimit hapësinor, ndërtimit dhe banimit, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit.

26. Intervistë me z. Arsim Kuliqi, Kryeshef Ekzekutiv i Agjencisë së Kosovës për Eficiencë të Energjisë, Ministria e Integritimit Evropian, Kosovë.

27. Komisioni Evropian (2020). Raporti i Progresit për Kosovën.

28. ISBEM është një ndërfaqe e softuerit e patentuar (proprietare) pa kosto për Modelin e Thjeshtësuar të Energjisë së Ndërtesave (SBEM) që është krijuar për qëllimin e tregimit të pajtueshmërisë me rregulloret e ndërtimit të Mbretërisë së Bashkuar, pjesa L2a dhe L2b në Angli në lidhje me emetimet e karbonit nga ndërtesat joshhtëpiake.

29. Intervistë me z. Arsim Kuliqi, Kryeshef Ekzekutiv i Agjencisë së Kosovës për Eficiencë të Energjisë, Ministria e Integritimit Evropian, Kosovë.

30. Rregullorja nr. 05/2018 për One-Stop-Stop për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë. Gazeta Zyrtare, Kosovë.

31. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (2019) Raporti Vjetor i Zbatimit.

Prioritetet afatmesme të PKZMSA-së 2020-2024 janë: rishikimi i Strategjisë 10-vjeçare të Energjisë, adoptimi i Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë (PKEK) 2021-2030, dekomisionimi i pjesëve joaktive të TC 'Kosova A', zbatimi i masve të efijencës së energjisë në ekonomitë familjare përmes Projektit Peizazhi i Energjisë së Besueshme (RELp), dhe investimeve të infrastrukturës energjetike për të zvogëluar humbjet e energjisë nga operatori i sistemit të shpërndarjes.

Në lidhje me zhvillimin e burimeve të ripërtëritshme, PKZMSA 2020-2024 parashikon anëtarësimin e ZRRE-së në ACER (Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë), miratimin e koncept dokumentit mbi caqet e burimeve të ripërtëritshme dhe kryerjen e analizës së kostos dhe përfitimeve për përmirësimin e ngrohjes qendrore të qyteteve.

Po përsërisim, nevoja për të adoptuar një strategji të re të energjisë vlerësohet si një prioritet i lartë për përcaktimin e së ardhmes së strukturës së përgjithshme të gjenerimit të energjisë në Kosovë, brenda së cilës pritet të vendosen caqe të reja për efijencën e energjisë dhe burimet e ripërtëritshme. PKZMSA 2020-2024 thekson nevojën e harmonizimit midis caqeve të reja të pjesëmarrjes së burimeve të ripërtëritshme me caqet e BE-së për vitin 2030. Ministria e Energjisë dhe Ambientit (MEA), e mbështetur nga KE-ja është në proces të kryerjes së studimit vlerësues të efijencës së energjisë në Kosovë dhe potencialeve të burimeve të ripërtëritshme, i cili studim pritet të finalizohet deri në fund të vitit 2020.³² Në ndërkohë, Strategjia e Energjisë 2017-2026 parashikon pjesëmarrje prej 29.47% të energjisë së ripërtëritshme (mbi baza vullnetare), shumë më e lartë sesa caqet e PKVER 2011-2020, një cak ky që QK gjithashtu nuk ia doli të arrijë.

Sistemet e ngrohjes së qytetit paraqiten si prioritet në kuadër të PKZMSA 2017-2021. Deri më tani, QK arriti vetëm të zgjerojë dhe përmirësojë sistemet e ngrohjes së qytetit në Prishtinë dhe Gjakovë. Sidoqoftë, zhvillimi i sistemeve të ngrohjes së qytetit në sistemet e qyteteve të tjera është planifikuar vetëm përmes analizës së kostos dhe përfitimeve. Planit të veprimit i mungojnë masat konkrete dhe të shpejta për ndërtimin e ngrohjes qendrore nëpër qytetet

32. Intervista me Lendita Gashi, Energjia dhe Transporti, Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë.

33. ASK ka publikuar për herë të parë "Konsumi i energjisë në ekonomitë familjare" për vitin 2015. Sipas llojit të burimit të nxehtësisë rreth 70.35% e ekonomive familjare përdorin dru, 18.18% përdorin energji elektrike, 7.10% përdorin thengjill, 4.02% përdorin ngrohje qendrore ose të qytetit, dhe 0.35% përdorin alternativa të tjera.

më të mëdha të Kosovës, duke marrë parasysh numrin e lartë të ekonomive familjeve që djegin qymyr dhe dru për ngrohje.³³

Zhvillimi i ngrohjes së qytetit mund të ndikojë shumë si në kursimin e energjisë në ekonomitë familjare ashtu dhe në ritjen e kogjenerimit të energjisë termike dhe të ketë një ndikim pozitiv mjedisor në Kosovë.

PKZMSA 2017-2021 parashikoi masa të kursimit të energjisë vetëm në një numër shumë të vogël të ndërtesave publike. PKZMSA 2020-2022 parashikoi rritje të kursimit të energjisë përmes marrjes së masave në 1.200 shtëpi dhe në 10 ndërtesa shumëkatëshe, një projekt që do të zbatohet nga Projekti Peizazhi i Energjisë së Besueshme (RELp) - Fondacioni i Mijëvjeçarit në Kosovë (MFK). Këto masa do të zbatohen për herë të parë në ndërtesat e sektorit privat. Të përsërisim edhe një herë, investimet madhore në kursimin e energjisë mbështeten në zbatimin dhe financimin e donatorëve.

QK është në proces të përgatitjes së projekt PKEK³⁴ 2021-2030. Si strategjia e përditësuar e energjisë ashtu dhe PKEK duhet të jenë në harmoni, pasi ato trajtojnë të njëjtat fusha të përmirësimit. Hartimi i këtij dokumenti është ende në fazën e parë, ndërsa procesi i hartimit u zgjat për shkak të pandemisë COVID-19.³⁵

Masat afatshkurtra të parashikuara për t'u përfunduar deri në fund të vitit 2020 përfshijnë: miratimin e akteve nënligjore që rrjedhin nga ligji për efijencën e energjisë (blerja e produkteve me nivel të lartë të performancës energjetike, kriteret minimale për auditimet e energjisë dhe shabllonet për raportet vjetore të progresit të PKVEE), adaptimi i PKVEE 2019-2021 dhe KEEF e disbursuar.

Rrjedhimisht, QK duhet të adoptojë këto akte nënligjore sa më shpejt që të jetë e mundur, sepse kjo do të ndihmojë në shtytjen dhe promovimin e blerjes së produkteve dhe shërbimeve efijente dhe fillimin e auditimit të energjisë.

PKZMSA 2020-2024 nuk ka arritur të adresojë pengesat reale që ekzistojnë në kursimin e energjisë dhe zhvillimin e burimeve të ripërtëritshme. Prioritete konkrete do të duhej të jenë vendosur në drejtim të: 'One-Stop-Shop', zhvillimit të shërbimeve të auditimit të energjisë dhe auditorëve të energjisë, skemës së favorshme të tregut të bazuar në burimet e ripërtëritshme dhe funksionalizimin e platformës së monitorimit dhe verifikimit. Zgjidhja e këtyre masave jo vetëm që do të përmirësonte në mënyrë drastike kursimin e energjisë dhe sektorin e burimeve të ripërtëritshme, për më tepër, ajo do të ndihmonte në krijimin e një korize të favorshme për investimet dhe zhvillimin e këtyre sektorëve.

Padyshim, QK ka nevojë të investojë në zgjerimin dhe përmirësimin e rrjetit elektrik, që është thelbësor për të rritur zhvillimin e sektorit të energjisë në Kosovë. Sidoqoftë, përveç përparësive në infrastrukturën energjetike, qeveria duhet gjithashtu të vendosë si një prioritet të lartë krijimin e një infrastrukture që lehtëson zbatimin e projekteve që janë të orientuara drejt burimeve të qëndrueshme dhe të ripërtëritshme.

34. PKEK-të u prezantuan nga Rregullorja për qeverisjen e unionit të energjisë dhe veprimit klimatik (BE) 2018/1999, të rënë dakord si pjesë e pakos së Energjisë së Pastër për të gjithë evropianët, të miratuar në vitin 2019.

35. Intervista me Avni Sfishta, Udhëheqës i ekipit, Projekti i Kosovës për Efijencën e Energjisë, GlZ Kosovë.

5. Agjenda e Reformave Evropiane

Agjenda e Reformave Evropiane (ARE) është strukturuar bazuar në tri fusha: I) qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit, II) konkurrueshmëria dhe klima e investimeve, dhe III) arsimi dhe punësimi. Dy shtyllat e saj shërbejnë si një kornizë afatmesme e politikave dhe një kornizë zbatimi afatshkurtër që përshkruan veprimet, treguesit, afatet dhe entitetet përgjegjëse për secilin fokus.

Shtylla e Konkurrueshmërisë dhe Klimës së Investimeve përmban shtatë prioritete dhe 78 veprime. Ato që lidhen me EE dhe BRE janë theksuar nën prioritete nr. 2.5, dhe nr. 2.7 (shih tabelën 2). QK përgatit raporte të rregullta mbi zbatimin e ARE. Raporti i fundit, i përgatitur nga ish- MIE mbulon periudhën e zbatimit të 2016-2018 sipas planit të veprimit.³⁶ Raporti thekson se nga 13 veprime, 10 janë zbatuar plotësisht dhe 3 janë në proces. Deri më tani, edhe 3 veprimet shtesë janë zbatuar me sukses. Ky punim vlerësoi planin e veprimit të ARE përmes një pasqyre tabelore të statusit të zbatimit dhe nivelit të zbatimit të secilit aktivitet/tregues (shih Tabelën 2. Matrica e zbatimit të ARE).

Aktivitetet nën Prioritetin nr. 2.5.

Aktiviteti nr. **2.5.5.** Publikimi i statistikave të shkurtuara të energjisë dhe statistikave vjetore të efikasitetit të energjisë të prodhuara në përputhje me standardet ndërkombëtare nën prioritetin nr. **2.5** Zhvillimi i një numri të statistikave kryesore sektoriale për hartimin e politikave në fushën e statistikave kombëtare të energjisë është implementuar. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka bërë progres të rëndësishëm në sigurimin e statistikave të energjisë. Që nga viti 2014, ajo ka harmonizuar publikimet e saj të statistikave të energjisë me kërkesat e Eurostat-it. Lidhur me statistikën e efikasitetit të energjisë, ASK filloi publikimin e tyre në vitin 2018 për periudhën referuese 2011-2016 për sektorët e ekonomisë familjare dhe të industrisë. Publikimi i sektorëve të shërbimeve dhe transportit do të jetë i disponueshëm në vitin 2020.

Aktivitetet nën Prioritetin nr. 2.7

Prioriteti nr. **2.7** Rritja e sigurisë së energjisë dhe miratimi i një strategjie gjithëpërfshirëse të energjisë për periudhën 2017-2026 janë të ndërlidhura me pronësinë e TC 'Kosova B', afatin e fundit për dekomisionimin e TC 'Kosova A', përditësimin e PKVER dhe vlerësimin e mekanizmit të financimit për EE në sektorin publik dhe privat.

Nr. 2.7.1. Miratimi i strategjisë së energjisë 2016-2025. Siç u theksua në seksionin e mëparshëm, në vitin 2018, pas një vonese dyvjeçare, Strategjia e Energjisë 2017-2026 u miratua, duke krijuar një efekt shumëshprehësorë të vonësës së masave zbatuese. Arsyeja prapa një strategjie të re të energjisë, siç është shpjeguar në seksionin e mëparshëm, qëndron në gjendjen e përditësuar të energjisë në Kosovë.

Lidhur me aktivitetin **nr.a.1.** Vendimi mbi Modalitetet e TC 'Kosova B' është implementuar me sukses në vitin 2017. Rrjedhimisht, TC 'Kosova B' do të jetë nën pronësi publike (të paktën 51% të aksioneve) për 10 vitet e ardhshme, gjë që krijon një status të qëndrueshëm investimi për QK.

36. Raporti Final mbi Zbatimin e Agjendës së Reforma Evropiane ARE 2016 - 2018. Prishtinë, 2018.
http://mei-ks.net/repository/docs/raporti_mbi_zbatimin_e_era_1_11_2016-_30_11_2018_final_eng.PDF

Tabela 2. Matrica e zbatimit të ARE

Nr.	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit	Statusi i zbatimit	NZ
			Po/Jo	4,3,2,1
2.5	Zhvillimi i një numri të statistikave kryesore sektoriale për hartimin e politikave në fushën e statistikave kombëtare të energjisë	2.5.5. Publikimi i statistikave të shkurtuara të energjisë dhe statistikave vjetore të efikasitetit të energjisë të prodhuara në përputhje me standardet ndërkombëtare.	Po	4
		1.Miratimi i një strategjie gjithëpërfshirëse të energjisë për periudhën 2016-2025	Po	4
2.7	Rritja e sigurisë së energjisë dhe miratimi i një strategjie gjithëpërfshirëse të energjisë për periudhën 2017-2026	a.1. Vendimi mbi modalitetet e pronësisë për Kosova B	Po	3
		a.2. Investimet e reja në gjenerimin e energjisë (të gjitha burimet)	Po	2
		a.3. Afati për dekomisionimin e Kosova A do të përcaktohet.	Jo	2
		b.1. Raporti i dytë mbi progresin e zbatimit të PKVER	Po	3
		b.2. Miratimi i PKVER-it të përditësuar, përfshirë masat e duhura për të siguruar që Kosova të arrijë caqet e energjisë së ripërtëritshme prej 25% në vitin 2020	Po	4
		c.1. Misioni TALEX do të vlerësojë modalitetet e një mekanizmi financimi për efikasitetin e energjisë dhe masat mjedisore	Po	4
		c.2. Vlerësimi dhe vendimi i marrë mbi modalitetet e një mekanizmi financimi për të mbështetur investimet në efikasitetin e energjisë dhe mjedisin	Po	3
		c.3. Miratimi i PKVEE 2016-2018.	Po	4
		c.4. Miratimi i ligjit për Performancën e Energjisë së Ndërtesave.	Po	4
		d.1. Miratimi i legjislacionit sekondar për transpozimin e Direktivës 2010/31/BE d.1.a. Rregullore për përcaktimin e performancës minimale të energjisë në ndërtesat e reja të banimit, ndërtesat në rinovim dhe llojet e tjera të ndërtesave të banimit d.1.b. Rregullore për certifikatën e performancës së energjisë për ndërtesat e reja dhe ndërtesat e tjera d.1.c.Rregullore për inspektimin e sistemit të ngrohjes dhe pajisjeve të kondicionimit të ajrit	Po	4

Nr.a.2. Investimet e reja në gjenerimin e energjisë (të gjitha burimet), që nënkupton sigurimin e investimeve në gjenerimin e energjisë elektrike nga burime të llojllojshme. Kosova ka potencial të konsiderueshëm për të integruar BRE në sistemin e saj të gjenerimit të energjisë. Ndërkohë që ka pasur disa investime brenda sistemit të transmissioinit të energjisë, nuk janë siguruar investime të rëndësishme në gjenerimin e energjisë. Programi IPA 2014 dhe programi IPA 2018 fokusohen më shumë në mbështetjen financiare të rehabilitimit mjedisor të të dy TC. Deri më tani, kapaciteti i instaluar i gjenerimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme është 154 MW³⁷, dmth vetëm 10.7%³⁸ të kapacitetit total të gjenerimit.

QK në strategji dhe plane të ndryshme ka përfshirë hidrocentralin e Zhurit me kapacitet të instaluar prej 295 MW. Përkundër planifikimit të përsëritur, ai mbeti një projekt “i vjetër” brenda strategjive. Asnjëherë nuk pati një shans të zhvillohej për shkak të energjisë ujore të llogaritur joreale, shqetësimeve të mëdha mjedisore dhe mosmarrëveshjeve politike (devijimi i lumit) me Shqipërinë. Shoqëria civile ka kërkuar që projekti i vjetër i HC Zhur të hiqet nga të gjitha planet dhe dokumentet strategjike sepse ky projekt, përveç që ka probleme të mëdha në vetvete për sa i përket realizueshmërisë ekonomike dhe racionalitetit politik, sasia e energjisë elektrike të gjeneruar gjithashtu nuk justifikon investimet.³⁹

Nr.a.3. Afati i fundit për dekomisionimin e TC ‘Kosova A’, ka qenë një çështje e pazgjidhur për qeverinë e Kosovës për vite me radhë. Dekomisionimi i ‘Kosova A’ është zgjatur, edhe pse qeveria e Kosovës u zotua të respektojë dekomisionimin e saj në marrëdhëniet e saj me BE-në. Afati i caktuar për vitin 2017 u vendos bazuar në logjikën e ‘sa më shpejt që Kosova të zhvillojë kapacitete të reja gjeneruese, aq më shpejt do të jetë në gjendje të dekomisionojë TC ‘Kosova A’. Prandaj, meqenëse qeveria e Kosovës nuk zhvilloi kapacitete shtesë të gjenerimit, dekomisionimi i TC ‘Kosova A’ u shty përsëri. Afati i ri i caktuar për dekomisionimin e TC ‘Kosova A’ është fundi i vitit 2023 (Strategjia e Energjisë 2017-2026).

Raporti i dytë mbi progresin e zbatimit të PKVER siç kërkohet nga **b.1.**, u përgatit në fillim të vitit 2017. **b.2.** Miratimi i PKVER-it të përditësuar, përfshirë masat e duhura për të siguruar që Kosova do të arrijë caqet prej 25% të energjisë së ripërtëritshme në vitin 2020. Pas një vonese dyvjeçare, QK në vitin 2020 arriti të miratojë versionin e përditësuar të PKVER 2018-2020. Ndërsa PKVER 2011-2020 synonte pjesëmarrje më të lartë (29.47%) të burimeve të ripërtëritshme mbi baza vullnetare, versioni i përditësuar i PKVER ul pritjet e arritjeve deri në cakun e detyrueshëm prej 25% të pjesëmarrjes së burimeve të ripërtëritshme. Fatkeqësisht, siç u cek më parë, QK nuk arriti asnjë nga caqet.

c.1. Misioni i TAIEX-it për të vlerësuar modalitetet e një mekanizmi financimi për eficiencën e energjisë dhe masat mjedisore të kryera në vitin 2017. Një nga rekomandimet ishte që Qeveria e Kosovës të kalojë nga tarifa nxitëse (“Feed-in”) në një skemë mbështetëse më konkurruese. Një skemë mbështetëse e bazuar në primet e paguara mbi çmimin e energjisë elektrike në vend

të tarifave administrative nxitëse, mbetet për tu prezantuar. Siç është raportuar nga ZRRE, MEA mbështetet nga BERZh-i për të zhvilluar skemën mbështetëse konkurruese më të përshtatshme për Kosovën.⁴⁰

c.3. PKVEE 2016-2018 i miratuar në vitin 2017, përcakton një cak të eficiencës së energjisë në 9%. Fatkeqësisht, deri në vitin 2019, u regjistrua një progres i caqeve prej 4.1% (92 ktoe)⁴¹ kursime në EE të konsumit final të energjisë. Drafti përfundimtar i PKVEE 2019-2021 është në pritje. Si pasojë, me miratimin e PKVEE 2019-2021, QK është zotuar që për periudhën e ardhshme të fillojë rritjen e numrit të Ndërtesave me Energji Pothuajse Zero në ndërtesat publike deri në vitin 2021. Si i tillë, ky angazhim përfaqëson një moment të rëndësishëm kulmor drejt kursimit të energjisë; megjithatë, një angazhim i tillë kërkon shumë më shumë kapacitet teknik dhe financiar, i cili i mungon Qeverisë. Fatkeqësisht, QK për dallim nga vendet e saj fqinje, ende nuk arriti të fillojë promovimin e iniciativave si Programi Rajonal i Eficiencës së Energjisë (REEP).



37. Burimi nga Departamenti i Energjisë, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit. Marrë në korrik, 2020

38. Biomasa e përdorur për ngrohje nuk është llogaritur, për shkak të interesit për të paraqitur vetëm kapacitetin e instaluar të gjenerimit nga BRE në proporcion me kapacitetin total të instaluar të gjenerimit në Kosovë. Burimi i të dhënave për kapacitetin e instaluar: Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë, Divizioni i Kogjenerimit dhe Eficiencës.

39. Balkan Green Foundation, Instituti për Politika Zhvillimore (Mars 2019), “Hidrocentralet në Kosovë, kapaciteti dhe potenciali i tyre real”.

40. Intervistë me Fidan Isufi, Analist i Strukturës së Tarifave në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë. Kosovë

41. Komisioni Evropian (2019) Raporti i Progresit të Kosovës.

Nga rishikimi i zbatimit të ARE rezultoi se nga 15 aktivitete/tregues, vetëm dy (a.2. dhe a.3.) nuk janë duke u zbatuar. Aktivitetet/treguesit e ARE janë zbatuar me 86.6%. Sa i përket nivelit të zbatimit, prioriteti rezulton të jetë 65% të përfunduara, 20% pjesërisht të përfunduara dhe 13.5% në proces.

Nëse shikohen shifrat e zbatimit, mund të krijohet ndjesia se ARE është zbatuar me sukses dhe se ka pasur një ndikim të jashtëzakonshëm në “epokën” e reformave për rritjen e efijencës së energjisë dhe diversifikimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë. Duke shikuar përtej shifrave, ky punim ka rishikuar secilin output të aktivitetit veç e veç, dhe ka rishikuar rezultatet e ARE-s në tërësi.

Fatkeqësisht, ARE si një dokument i plotë i reformave nuk kishte një ndikim të madh në rritjen e efijencës së energjisë dhe diversifikimin e reformave të burimeve të ripërtëritshme të energjisë. Kështu, QK nuk arriti të zbatojë dy nga aktivitetet më të rëndësishme të planifikuara, në lidhje me sigurimin e furnizimit me energji dhe dekomisionimin e TC ‘Kosova A’.

Sfida më e madhe që ARE nuk ka një ndikim të madh pozitiv është se shumica e prioritetëve të përcaktuara janë të vjetruara në “fazën” e re të energjisë, në të cilën Qeveria e Kosovës e gjen vetën. Për shembull: Treguesi **c.4.** kur vlerësohet në raporte vlerësohet si i zbatuar. Megjithëse QK përfundoi me sukses misionin TAIEX, ajo nuk arriti të zbatojë rekomandimin më të rëndësishëm nga misioni i ekspertëve për të kaluar nga tarifat nxitëse në skemën tjetër të mbështetjes për të mbështetur gjeneratorët e ripërtëritshëm. Duke pasur një procedurë të komplikuar dhe të zgjatur licencimi⁴², kohëzgjatjen e shkurtër të tarifave nxitëse dhe mungesën e ankandëve, Kosova nuk mund të konkurrojë me vendet e saj fqinje në tërheqjen e investitorëve të mëdhenj për gjenerimin e burimeve të ripërtëritshme. Prandaj, outputi i treguesit mund të jetë pozitiv, por rezultati nuk arrin të jetë pozitiv.

Sfida e dytë e ARE është se prioritetet e përcaktuara dhe aktivitetet/treguesit përkatës kanë një dallim të madh në rëndësinë dhe potencialin e ndikimit, e prapëseprapë ata vlerësohen si të njëjtë. Për më tepër, treguesit nuk janë specifikuar në mënyrë që të kenë një rezultat pozitiv të madh, por vetëm një output pozitiv. Prandaj, QK, me rastin e përcaktimit të prioritetëve të reja, duhet të vlerësojë prioritetet edhe sipas nivelit të ndikimit dhe të specifikojë treguesit në një mënyrë më efikase.

42. Në ZRRE, ka aplikime që presin për licencë për më shumë se dy vjet.

6. Programet e Reformave Evropiane

PRE-të kryejnë një funksion jetik në strategjitë buxhetore të vendeve candidate të BE-së duke përmbajtur parashikime makroekonomike afatmesme për tre vitet e ardhshme. Çdo masë reforme parashikon: I) aktivitetet që do të zbatohen çdo vit, II) vlerësimet e kostos dhe buxhetin, dhe III) rezultatet e pritura.

Qeveria e Kosovës hartoi dhe miratoi pesë PRE. PRE 2018-2020, PRE 2019-2021 dhe PRE 2020-2022 janë analizuar për këtë punim. Secili përbëhet nga njëzet masa të reformës strukturore, dy të dedikuara për sektorin e energjisë, tri gjithsej.

Efijenca e energjisë dhe burimet e ripërtëritshme të energjisë janë pjesë e aktiviteteve të PRE, por qeveria e Kosovës nuk ka arritur t'i përfundojë të gjitha në kohë. Përveç kësaj, shumë prej aktiviteteve të planifikuara janë një gjest shumë i vogël krahasuar me problemin e sektorit të energjisë në Kosovë. Nëse QK vazhdon me të njëjtin ritëm të rehabilitimit të ndërtesave të veta, afërsisht 20-30 ndërtesa në vit, do t'i duhen të paktën 30 vite për të përfunduar të gjitha ndërtesat.⁴³

Furnizimi jo i besueshëm me energji elektrike po ndikon në rritjen ekonomike të vendit duke shtrembëruar aktivitetin biznesor. Që Kosova të stabilizojë furnizimin e saj me energji elektrike dhe të forcojë konkurrencën, ajo duhet të çlirojë potencialin e saj për kapacitete të ripërtëritshme të gjenerimit, të ndryshojë rregullat e tregut për investime të ripërtëritshme dhe të dizjnojë tarifa që pasqyrojnë koston aktuale të energjisë.⁴⁴

Investimet në burimet e ripërtëritshme të energjisë mund ta kthejnë Kosovën nga një shoqëri jo e besueshme dhe toksike, në një vend për jetesë të qëndrueshme dhe biznes: në fund të fundit, një shoqëri e shëndoshë do të thotë një shoqëri produktive.⁴⁵

Ju lutemi shikoni tabelën e matricës së zbatimit të të gjitha aktiviteteve të planifikuara nga PRE 2018-2020, PRE 2019-2021 dhe PRE 2020-2022.

43. “QK zotëron afërsisht 1000 ndërtesa në të gjithë Kosovën.” Intervistë me z. Arsim Kuliqi, Kryeshef Ekzekutiv i Agjencisë së Kosovës për Efijencë të Energjisë, Ministria e Integritit Evropian, Kosovë.

44. Që nga viti 2017, dialogët vjetorë të politikës ekonomike e kanë këshilluar Kosovën të krijojë një kornizë që mbështet në mënyrë të qartë sektorin e energjisë.

45. Kjo fletë faktesh fokusohet në punësimin në sektorët e energjisë së ripërtëritshme dhe efijencës së energjisë në Shtetet e Bashkuara dhe në të gjithë botën. Sipas Raportit të Punësimit të Energjisë në SHBA të vitit 2019 (USEER), 611,000 njerëz punojnë në industritë e teknologjisë me emisione zero, përfshirë burimet e ripërtëritshme dhe bërthamore në Shtetet e Bashkuara. Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë së Ripërtëritshme (IRENA) regjistroi punësim edhe më të lartë të energjisë së ripërtëritshme në Shtetet e Bashkuara në 855,000 vende pune direkte dhe indirekte në vitin 2018. Vendet e punës në efijencën e energjisë përjetuan një rritje të konsiderueshme - sektori tani punëson më shumë se 3 milion njerëz në Shtetet e Bashkuara. IRENA raporton se, globalisht, sektori i energjisë së ripërtëritshme punësoi 11 milion njerëz në vitin 2018, 700,000 më shumë se në vitin 2017.) citim: linku në vijim: <https://www.eesi.org/papers/view/fact-sheet-jobs-in-renewable-energy-energy-efficiency-and-resilience-2019>

Tabela 3. Matrica e zbatimit të PRE-ve.

Afati kohor i aktiviteteve të PRE					
Masat e Reformës	2018- 2020		2019- 2020		2020- 2022
	Aktivitetet	NZ	Aktivitetet	NZ	Planned activitis
	2018		2019		2020
(PRE 2018-2020 & PRE 2019- 2021 & PRE 2020-2022) #1 Reduktimi i konsumit të energjisë përmes masave të efikasitetit të energjisë.	1) Miratimi i Ligjit për efikasitetin e energjisë	4	1)Zbatimi i masave të EE në 50 ndërtesa publike dhe fillimi i zbatimit në 30 ndërtesa të tjera publike	3	1) Zbatimi i masave të EE në 50 ndërtesa publike
	2) Modalitetet e mekanizmit të financimit për të mbështetur investimet në efikasitetin e energjisë brenda ligjit;	4	2) Zbatimi i masave të EE në ekonomi familjare në 600 shtëpi, 5 ndërtesa shumëkatëshe dhe instalimi i njehsorëve të konsumit të ngrohjes dhe valvuleve termostatike për rreth 3000 ekonomi familjare në Prishtinë (RELP)	2	2) Zbatimi i masave të EE në 1200 shtëpi dhe 10 ndërtesa shumëkatëshe (RELP)
	3) Zbatimi i masave të efikasitetit të energjisë në 60 ndërtesa publike;	4	3) Instalimi i njehsorëve për matjen e konsumit të ngrohjes dhe valvuleve termostatike për rreth 3000 ekonomi familjare në Prishtinë (RELP)	2	3) Instalimi i njehsorëve për matjen e konsumit të ngrohjes dhe valvuleve termostatike në 4500 ekonomi familjare në Prishtinë
	4) Studim i fizibilitetit për sistemet e ngrohjes qendrore për Drenas, Obiliq, Prizren, Pejë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë dhe Zveçan;	1	3) Alokimi i granteve për Masat e Efikasitetit për Bizneset e Grave (RELP)	3	4) Alokimi i granteve për masat e EE për bizneset e grave (RELP)
	5) Zgjerimi i Rrjetit të Kogjenerimit për Komunën e Prishtinës;	2	4) Ndërtimi i ngrohjes qendrore në Gjakovë me burime të energjisë së biomasës (KE).	3	5) Zbatimi i planeve të investimeve kapitale për të forcuar dhe zvogëluar humbjet teknike dhe komerciale
	6) Ndërtimi i impiantit të ngrohjes qendrore në Gjakovë me burim energjie të biomasës (KE).	1	5) Funkcionalizimi i KEEF.	4	6) Zbatimi i masave të EE në 12 ndërtesa publike në 4 komuna.
2019			2020		2021
	1) Zbatimi i masave të EE në 61 ndërtesa publike;	4	1) Zbatimi i masave të EE në rreth 25 ndërtesa publike (MZHE / KAEE).	4	1) Zbatimi i masave të EE në 15 ndërtesa publike
	2) Zhvillimi i dizajnit teknik për implementimin e sistemeve të ngrohjes qendrore për Drenas, Kastriot, Prizren, Pejë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë dhe Zveçan.	1	2) Zbatimi i masave të EE në ekonomi familjare në 1200 shtëpi, 10 ndërtesa shumëkatëshe dhe instalimi i njehsorëve të konsumit të ngrohjes dhe valvuleve termostatike për rreth 4500 ekonomi familjare në Prishtinë (MFK);	2	2) Zbatimi i masave të EE në ekonomitë familjare brenda RELP në 1200 shtëpi, dhe në 10 ndërtesa shumëkatëshe dhe instalimi i njehsorëve për matjen e konsumit të ngrohjes dhe valvuleve termostatike për rreth 4500 familje në Prishtinë
				4	3) Alokimi i granteve për masat e Efikasitetit për Bizneset e Grave (MFK);
				4	4) Zbatimi i planit të investimeve kapitale për forcimin, rrjetëzimin dhe zvogëlimin e humbjeve teknike dhe komerciale.
					5) Zbatimi i planit të investimeve për forcimin, zgjerimin e rrjetit dhe projektet e tensionit të mesëm për të zvogëluar humbjet teknike dhe komerciale (KESCO).

Afati kohor i aktiviteteve të PRE					
Masat e Reformës	2018- 2020		2019- 2020		2020- 2022
	Aktivitetet	NZ	Aktivitetet	NZ	Aktivitetet e planifikuara
	2020		2021		2022
	1)Zbatimi i masave të efikasitetit të energjisë në 52 ndërtesa publike	4	1) Zbatimi i masave të EE në ekonomitë familjare në 1200 shtëpi, dhe në 10 ndërtesa shumëkatëshe dhe instalimi i njehsorëve të konsumit të ngrohjes dhe valvuleve termostatike për rreth 4500 ekonomi familjare në Prishtinë (MFK).	2	1) Zbatimi i planit të investimeve kapitale për forcimin, zgjerimin e rrjetit dhe projektet e tensionit të mesëm për të zvogëluar humbjet teknike dhe komerciale (KEDS).
	2)Zbatimi i sistemeve të ngrohjes qendrore për Drenas, Kastriot, Prizren, Pejë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë dhe Zveçan.	1	2) Alokimi i granteve për Masat e Efikasitetit për Bizneset e Grave (MFK).	3	2) Përfundimi i studimit të fizibilitetit dhe analiza e kosto-përfitimit për ndërtimin e ngrohjes së qytetit.
			3) Zbatimi i planit të investimeve për forcimin, zgjerimin e rrjetit dhe projektet e tensionit të mesëm për të zvogëluar humbjet teknike dhe komerciale (KESCO).		
2018			2019		2020
(PRE 2018-2020 & PRE 2019- 2021) # 2 Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve gjeneruese të energjisë	1) Zhvillimi i projektit TC Kosova e Re.	4	1) Fillimi i ndërtimit të TC Kosova e Re	4	1) Ndryshimi i legjislacionit sekondar për mbështetjen e projekteve të ripërtëritshme duke aplikuar oferta / ankande konkurruese.
	2) Zbatimi i tre projekteve të centraleve solare me një kapacitet total prej 9 MW.	1	2) Zbatimi i katërmbëdhjetë projekteve të reja të HC-eve të vogla me kapacitet total të instaluar prej 61.8 MW	2	2) Reforma e kornizës rregullatore që mbështet prodhimin e energjisë elektrike nga gjeneratorët e vetë-konsumit.
(PRE 2020-2022) # 2 Rritja e diversitetit të burimeve të energjisë	3) Zbatimi i pesë projekteve të vogla hidroenergjitike me një kapacitet total të instaluar prej 22.1 MW, investim privat.		3) Zbatimi i dy projekteve të reja të energjisë së erës me një kapacitet total të instaluar prej 32.4 MW		3) Zbatimi i katër projekteve të reja të hidrocentraleve të vogla me kapacitet total të instaluar prej 15.60 MW.
			4) Zbatimi i dy projekteve të Energjisë Diellore me kapacitet total prej 3MW dhe 0.4MW.	4	4) Zbatimi i tre projekteve të reja të energjisë së erës me kapacitet total të instaluar prej 105 MW.
					5) Zbatimi i dy projekteve të reja të panelit fotovoltaik me një kapacitet prej 3.4 MW.
					6) 200 praktika profesionale për gratë në sektorin e energjisë.
					7) Përgatitja e dokumentacionit teknik për zhvillimin e një masterplani për shpërndarjen dhe furnizimin e gazit natyror.

Afati kohor i aktiviteteve të PRE					
Masat e Reformës	2018- 2020		2019- 2020		2020- 2022
	Aktivitetet	NZ	Aktivitetet	NZ	Aktivitetet e planifikuara
	2019		2020		2021
PRE 2019-2021) # 2 Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve gjeneruese të energjisë (PRE 2020-2022) # 2 Rritja e diversitetit të burimeve të energjisë	1) Zhvillimi i projektit TC Kosova e Re. 2) Zbatimi i 14 projekteve të reja të hidrocentraleve të vogla me kapacitet total të instaluar prej 61.8 MW, investim privat. 3) Zbatimi i dy projekteve të reja të energjisë së erës me një kapacitet total të instaluar prej 32.4 MW, investim privat.	2 3 4	1) Vazhdimi i konstruksionit fizik të TC Kosova e Re. 2) Zbatimi i katërmbëdhjetë projekteve të reja të HC-eve të vogla me kapacitet total të instaluar prej 37.86 MW. 3) Zbatimi i 3 projekteve të reja të energjisë së erës me kapacitet total të instaluar prej 105 MW. 4) Hartimi i PKEK.	1 3 4 2	1) Hartimi i Master Planit të Gazit për shpërndarjen dhe furnizimin me gaz natyror. 2) Zbatimi i tetë projekteve të reja (SHPP) me kapacitet të instaluar prej 30.58MW. 3) Zbatimi i një projekti të ri të energjisë së erës me kapacitet të instaluar prej 11MW. 4) Zbatimi i tre projekteve të paneleve fotovoltaike me një kapacitet prej 10 MW.
	2020		2021		2022
	1) Vazhdimi i ndërtimit të Termocentralit "Kosova e Re"; 2) Zbatimi i katërmbëdhjetë projekteve të reja të hidrocentraleve të vogla me kapacitet total të instaluar prej 37.86 MW, investim privat; 3) Zbatimi i tre projekteve të reja të energjisë së erës me kapacitet total të instaluar prej 105 MW, investime private.	1 3 3	1) Vazhdimi i konstruksionit fizik të TC Kosova e Re.	1	1) Zbatimi i tre projekteve të reja të hidrocentraleve të vogla me një kapacitet total të instaluar prej 11.3 MW 2) Zbatimi i tre projekteve të reja të paneleve fotovoltaike me një kapacitet prej 10 MW

NZ-Niveli i Zbatimit: 1 - I papërfunduar (Qeveria nuk e ka adresuar reformën ose qeveria ka ndërmarrë vetëm hapa fillestarë për të zbatuar reformën); **2** - Në proces (Qeveria është duke zbatuar reformën me disa rezultate fillestare); **3 - Pjesërisht i përfunduar** (Zbatimi i reformës është në fazë të avancuar dhe mbështetet nga rezultatet); **4 - I përfunduar** (Reforma është zbatuar plotësisht).

Masa numër një:
Reduktimi i Konsumit të Energjisë përmes Masave të Efiçencës së Energjisë

Masa numër një: Reduktimi i Konsumit të Energjisë përmes Masave të Efiçencës së Energjisë është pjesë e PRE 2018-2020 & PRE 2019-2021 & PRE 2020-2022.

Në vitin 2014, QK hartoi Ligjin për Masat e Efiçencës së Energjisë, ndërsa në vitin 2018, Ligji u miratua. Ligji nuk specifikon përgjegjësinë institucionale dhe ka dështuar në miratimin e akteve nënligjore - duke bllokuar zbatimin e masave të efiçencës së energjisë dhe duke përplasur Ligjin me direktivat e BE-së.

Aktivitetet e efiçencës së energjisë 2019 dhe 2020 të planifikuara për sektorin e ekonomive familjare varen nga fondet e jashtme sepse qeveria nuk ka alokuar burime buxhetore. Kjo është shumë shqetësuese pasi që financimi nga burimet e jashtme e bën të paqartë llogaridhënien. Për shembull, MFK u zotua të zbatojë masa të efiçencës së energjisë në 1.200 shtëpi, dhjetë ndërtesa shumëkatëshe dhe të instalojë njehsorë të konsumit të ngrohjes në 4.500 ekonomi familjare në Prishtinë; megjithatë, asnjë prej tyre nuk është zbatuar deri më tani. MFK dhe TERMOKOS kanë nënshkruar një memorandum mirëkuptimi, komisioni ende nuk është zhvilluar dhe përfundimi i projektit parashikohet për shtator të vitit 2021. Ky projekt është ende në pritje të zbatimit.

Në vitin 2019, KEEF u funksionalizua dhe filloi operimin në vitin 2020. Qëllimi i KEEF është të sigurojë burime financiare për komunat për të zbatuar masa të efiçencës së energjisë në tridhjetë ndërtesa në vit (ose njëzet vjet për të zbatuar masat e efiçencës së energjisë në të gjitha ndërtesat në pronësi shtetërore të Kosovës). Ky fond është progresiv, por nuk ka arritur të përfshijë konsumatorin më të madh të energjisë: sektorin privat. Duke dështuar në subvencionimin e financimit për masat e efiçencës së energjisë në sektorin privat, Kosova rrit humbjet e saj në planin afatgjatë, si në sektorin e energjisë ashtu edhe në atë të biznesit.

Mungesa e planifikimit të duhur po bllokon zbatimin e shumë masave të efiçencës së energjisë. Në vitin 2019, tetë komuna duhej të mermin ngrohje qendrore, por dështuan ekzekutimin pasi studimi i fizibilitetit ishte planifikuar për vitin 2020, duke e bërë të pamundur ekzekutimin e të parës pa e realizuar këtë të fundit.

QK duhet të jetë më delikate kur planifikon aktivitetet e saj për të siguruar që ato të ndjekin një afat të duhur kohor: Ligjet pa akte nënligjore janë të padobishme dhe vetëm tregojnë jostabilitetin e shtetit të ri.

Masa numër dy:

Zhvillimi i mëtejshëm i Kapaciteteve të Gjenerimit të Energjisë

Masa numër dy: Zhvillimi i mëtejshëm i Kapaciteteve të Gjenerimit të Energjisë është pjesë e PRE 2018-2020 & PRE 2019-2021.

Përkundër kritikave të shumta ndaj QK, ndërtimi i TC 'Kosova e Re' mbeti aktiviteti kryesor për vitet 2018 dhe 2019, por jo për vitin 2020. Në kohën kur e gjithë bota po përpiqet të ulë emetimet e CO₂, QK vazhdon me një projekt të bazuar në djegien e qymyrit. Për fat të mirë, Contour Global dhe BB kanë hequr dorë nga projekti. Kritikkat erdhën nga të dy - BE-ja dhe shoqëria civile dhe qytetarët, duke njohur TC 'Kosova e Re' si të rrezikshme si nga ana mjedisore ashtu dhe financiare. Sipas Raporti të KE 2020 për Kosovën "Një sërë aspektesh të projektit, përfshirë ndikimin e tij të mundshëm në financat publike, çmimet e energjisë elektrike për konsumatorët, biodiversitetin, ndryshimin klimatik dhe mjedisin, si dhe pajtueshmërinë e tij me rregullat e ndihmës shtetërore, kanë ngritur pyetje".⁴⁶ Disa studime shkencore kanë kritikuar TC 'Kosova e Re' për ndikimin e tij negativ në përdorimin e ujit dhe në vendbanimet mbi zonat e mihjeve.⁴⁷ Sipas shoqërisë civile, "i gjithë procesi u karakterizua nga parregullsi flagrante, ndryshime të shpeshta, mungesë transparence dhe konsultimesh me publikun."⁴⁸

Lidhur me burimet e ripërtëritshme të energjisë, të gjitha aktivitetet janë investime private të varura nga skema e tarifave nxitëse. Progres ka pasur në projektet solare dhe të erës: gjatë 2018-2020, më shumë se 10 MW fotovoltaike kanë filluar procesin, ndërsa 20 MW të tjera janë në pritje të zbatimit. Projekti i erës Kitka, me një kapacitet prej 32.4 MW filloi operimin në vitin 2018, ndërsa projekti në Bajgora, me kapacitet 105 MW është në ndërtim e sipër dhe pritët të fillojë operimin deri në vitin 2021.

Sidoqoftë, shumë projekte të tjera janë duke pritur për licencë nga ZRRE-ja, dhe pasi që skema mbështetëse e "tarifave nxitëse" është e kufizuar për gjeneratorët e rinj me burime të ripërtëritshme, shumë projekte të tjera dështuan të zbatohen që në fillim.

46. Komisioni Evropian (2020). Raporti i Progresit për Kosovën.

47. Lappe-Osthegea, T.; Andreasb, J. (2017) Energy justice and the legacy of conflict: Assessing the Kosovo C thermal power plant project (Drejësia energjetike dhe trashëgimia e konfliktit: Vlerësimi i projektit të termo-centralit Kosova C). Politika e Energjisë 2017

48. Instituti GAP (2018) Ndikimi i TC "Kosova e Re" në Tarifat e Energjisë Elektrike.



Masa numër dy (PRE 2020-2022): Rritja e Diversitetit të Burimeve të Energjisë

Masa numër dy: Rritja e Diversitetit të Burimeve të Energjisë është pjesë e vetëm PRE 2020-2022.

PRE 2020-2022 dhe PKZMSA 2020-2024 përfshijnë diversifikimin e energjisë përfshirë gazin natyror. Masterplani i gazit për shpërndarjen dhe furnizimin e gazit natyror tregon se QK planifikon të përdorë gazifikimin si një projekt afatmesëm infrastrukturë dhe kalimin nga qymyri në BRE. ZRRE dhe MZHE, tani MEA, mbështetur nga Projekti MCC Compact, po punojnë në krijimin e një kornize ligjore dhe infrastrukturore për zhvillimin e një rrjeti shpërndarës për gazifikim të përshtatshëm për gaz natyror të kompresuar (CNG) dhe gaz natyror të lëngshëm (LPG). Projekti i MCC Compact po mbështet QK në: (i) përgatitjen e një studimi teknik para-fizibiliteti për të lehtësuar zgjedhjen e kapacitetit specifik dhe llojeve të teknologjisë së infrastrukturës së gazit; dhe (ii) zhvillimin e një udhërrëfyese institucionale të sektorit të gazit.⁴⁹

QK duhet të zhvendosë paradigmen e saj të vjetër të qymyrit dhe hidrocentraleve dhe të njohë potencialin e saj për të stabilizuar sektorin e energjisë dhe ekonominë duke investuar në burime të ripërtëritshme të energjisë posaçërisht në energji me erë dhe solare. Duke prioritetizuar eficiencën e energjisë dhe angazhimet për burimet e ripërtëritshme të energjisë, Kosova do të investojë në inovacion dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, i cili do të lehtësojë procesin e integritit në BE.



49. Marrëveshja e Zbatimit ndërmjet Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës që vepron përmes Zyrës së Kryeministrit për Zhvillimin dhe Lehtësimin e Zbatimit të Kompaktit të Sfidës së Mijëvjeçarit. Datë 18 tetor 2019

7. Përfundimet

Ky punim nxjerr përfundimin se të gjitha dokumentet njohin sistemin e paqëndrueshëm të energjisë në Kosovë. Secili dokument mban masa dhe aktivitete të tolerueshme që synojnë të përmirësojnë sistemin e energjisë duke adresuar eficiencën e energjisë dhe burimet e ripërtëritshme të energjisë. Sidoqoftë, masat dhe veprimet e këtyre dokumenteve janë përsëritëse për shkak të paaftësisë së QK për të përmbushur zotimet e saj. Mos miratimi i akteve nënligjore të ligjit për eficiencën e energjisë është një shembull i paaftësisë së tillë të zbatimit sistematik. Edhe kur legjislacioni është në harmoni me acquis të BE-së, Kosova prapëseprapë ka mungesa për të frenuar konsumin e energjisë.

Mungesa e një strategjie gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme të energjisë bazuar në burime të ripërtëritshme dhe masa të forta të kursimit të energjisë bënë që QK të mbështetet në burime të paqëndrueshme për prodhimin e energjisë elektrike. Ishte planifikuar që QK të fillojë procesin e braktisjes së gjeneratorëve të vjetër me bazë qymyri që kanë një ndikim negativ mjedisor duke siguruar furnizimin me energji nga burimet e ripërtëritshme. QK pothuajse arriti caqet e pjesëmarrjes së burimeve të ripërtëritshme prej 25%, por meqenëse shumica e pjesëmarrjes bazohet në dru zjarri, ky mund të konsiderohet si një sukses i rremë.

Kosova është e brishtë për të pasur zgjidhje 'pa e vënë gishtin në kokë'; kështu, investimet në termocentrale të reja qymyri, hidrocentrale dhe përdorimi i biomasës (druve të zjarrit) janë alternativa të rrezikshme me pasoja afatgjata. Shfrytëzimi i burimeve natyrore do të çojë në një të ardhme malinje. Mbi të gjitha, mbrojtja e mjedisit është baza për qëndrueshmëri.

Të gjitha masat e PKZMSA-së dhe ARE-s lidhen me miratimin e strategjive kombëtare dhe planeve të veprimit, duke mos pasur mekanizma të vendosur monitorimi për zbatimin e tyre. Për më tepër, të dy dokumentet kanë shumë pak aktivitete konkrete që mund të ndikojnë në kursimin e energjisë dhe zhvillimin e projekteve të burimeve të ripërtëritshme. Kështu, mungesa e mekanizmit efektiv të monitorimit dhe e koordinimit ndërinstitucional në prioritet janë sfidat kryesore të hartimit dhe zbatimit të PKZMSA-ve dhe ARE të ndryshme.

PKZMSA-të dhe ARE nuk adresojnë pengesat reale në zhvillimin e burimeve të ripërtëritshme. Sfidat si mungesa e procesit të drejtpërdrejtë 'One-Stop-Shop' dhe mungesa e skemës mbështetëse bazuar në treg për burimet e ripërtëritshme bënë që zhvillimi i tyre të jetë i ulët dhe jotransparent. Për më tepër, QK nuk mund të konkurrojë me vendet e saj fqinje në tërheqjen e investitorëve të mëdhenj për gjenerimin e burimeve të ripërtëritshme. Sfidat më të mëdha që ARE nuk ka një ndikim të madh pozitiv është se shumica e prioritetëve të përcaktuara janë të vjetruara në "fazën" e re të energjisë në të cilën Qeveria e Kosovës e gjen veten.

Të gjithë PRE vendosin shumicën e masave dhe aktiviteteve në duart e partnerëve të jashtëm, duke krijuar rreziqe dhe varësi si nga aspekti i politikave ashtu edhe nga ai financiar. Shkalla e pasigurisë është e lartë për shkak të ndryshimeve që mund të ndodhin gjatë vazhdes së prioritetëve të donatorëve të jashtëm, institucioneve të financimit dhe të investitorëve.

Ndërsa perspektivat e integritit në BE nuk duhet të jenë motivi kryesor për QK për të zhvendosur sistemin e saj energjetik, është respektimi i marrëveshjeve kontraktuale me BE-në ai që do t'i mundësojnë Kosovës të jetë në gjendje të përparojë në një standard më të lartë jetese.

8. Rekomandimet

QK të zbatojë angazhimet e saj sipas ARE dhe PRE. Për më tepër, duhet gjithashtu të miratojë praktika dhe të përdorë mekanizma që do të përmirësojnë bashkëpunimin ndërinstitucional. Prioritetet e saj duhet të jenë në përputhje me dokumentet e BE-së dhe strategjitë përkatëse kombëtare. QK duhet të alokojë fonde dhe kapacitete të përshtatshme njerëzore për zbatimin e prioritetëve.

Si një vend aspirues i BE-së, Kosova duhet të promovojë gjenerimin e qëndrueshëm të energjisë dhe burimet e ripërtëritshme të energjisë. Për të bërë këtë, Kosova duhet të kryejë një analizë të thellë të rrugëve të saj të mundshme drejt një të ardhme më të gjelbër, të ndërtojë një kornizë më të fuqishme legjislativë dhe infrastrukturore dhe të investojë seriozisht në alternativa ndaj burimeve ndotëse. Fatkeqësisht, dështimi për të alokuar fondet e duhura për të zbatuar masat vetëm do të ngecë procesin e anëtarësimit të Kosovës në BE.

Duke krijuar mekanizma të zbatimit, monitorimit dhe zbatimit të ligjeve që janë në përputhje me acquis të BE-së, QK do të sigurojë që është serioze për zhvendosjen drejt një të ardhme të qëndrueshme.

Si e tillë, QK duhet të ndërmarrë qasje inovative dhe të qëndrueshme kur planifikon programin e strategjisë së energjisë për të arritur caqet e saj të ripërtëritshme. Caqet e saj të ripërtëritshme duhet të marrin parasysh ndikimin mjedisor dhe të garantojnë një rezultat të qëndrueshëm duke mos investuar në burime ndotëse.

Duke investuar në burime kosto-efektive, investimet e qeverisë në burimet e ripërtëritshme do të ndikojnë ndjeshëm në ekonominë dhe mirëqenien e banorëve të saj. Masat në PRE përfshijnë zbatimin e projekteve të ndryshme të BRE, të cilat sigurisht janë të mirëseardhura. Sidoqoftë, duke marrë parasysh kostot në rënie të energjisë së ripërtëritshme, Kosova mund të përparojë shumë më tej në synimet e saj të BRE duke miratuar procese konkurruese të përzgjedhjes për mbështetjen e saj të energjisë së ripërtëritshme. Vlen të theksohet se Komuniteti i Energjisë pritët të miratojë objektiva të rinj të energjisë së ripërtëritshme për vitin 2030, në përputhje me caqet e BE-së dhe kjo do të kërkojë përpjekje të konsiderueshme shtesë nga Kosova.

Që Kosova të përmbushë caqet e saj të BE-së, ajo duhet të zhvendosë strategjinë e saj të energjisë për të përfshirë masa konkrete për integrimin e burimeve të ripërtëritshme në të gjithë sektorët (energji elektrike, ngrohja, ftohja, transporti dhe uji) dhe jo vetëm sektorin e energjisë elektrike. Integrimi i burimeve të ripërtëritshme në sektorë të ndryshëm kontribuon në dekarbonizimin e energjisë dhe gjeneron punësim. Sidoqoftë, sistemi i saj aktual i tarifave nxitëse ka nevojë për rishikim.

Kosova duhet të investojë më tej në karburantin e parë të energjisë - eficiencën e energjisë. Ligji për eficiencën e energjisë dhe Fondi i EE si një mekanizëm mbështetës duhet të përmirësojë situatën. Kështu, Kosova duhet të miratojë stimuj për eficiencën e energjisë në sektorin privat dhe atë të ekonomive familjare.

Kosova duhet të zhvillojë një seri objektivash në PKZMSA që vendosin eficiencën e energjisë dhe energjinë e ripërtëritshme si një prioritet të lartë. Ajo gjithashtu duhet të krijojë një mjedis të favorshëm që do të rriste zhvillimin e tyre brenda sektorit publik dhe privat. PRE dhe ARE identifikojnë prioritetet e reformave, por reformat dhe hartimet në kohë kanë nevojë për përpjekje thelbësore.

Me zhvendosjen e sektorit të saj të energjisë drejt energjisë së ripërtëritshme dhe eficiencës së energjisë, Kosova mund të bëhet një shembull kryesor në rajon kur është fjala për stabilitetin afatgjatë. Jo vetëm që do të ulë nivelet e ndotjes së ajrit, por do të hapë dyer të reja për prosperitet në ekonominë e saj dhe përshejtimin e procesit të saj për t'iu bashkuar BE-së.

